KUSHTET E PËRGJITHËSHME TË SIGURIMIT TE PRONES

Neni 1
Dispozita të përgjithshme

1.1 "**Kushtet e Sigurimit"** kupton kushtet e përgjithshme të kontratës për Sigurim.
1.2 **"Siguruesi"** kupton kompaninë e Sigurimit që lëshon këtë kontratë.
1.3 **"I Siguruari"** kupton personin fizik ose juridik, interesi i të cilit mbrohet nga sigurimi.
1.4 **"Përfituesi"** kupton personin fizik apo juridik i cili ka interes pasuror mbi objekin e siguruar dhe në dobi të të cilit lidhet kontrata.

Neni 2
Objekti i sigurimit

I Siguruari mund të sigurojë pranë Siguruesit pasuri që e ka në pronësi të tij ose në çdo formë tjetër të pronësisë me kusht që të jetë një kontratë sipas kërkesave ligjore me pronarin e pasurisë apo sendin.

Siguruesi ofron Sigurim për objektet e mëposhtëme:
2.1 **Pasurinë e paluajtshme,** ndërtesat dhe pjesët e tjera të njësisë së siguruar;
Njësi e siguruar do të konsiderohet të jenë ndërtesat ose dhomat e ndërtesave ose vendet e përcaktuara si të tilla në kontratë.
2.2 **Pasurinë e luajtshme.**
Konsiderohen të gjitha pajisjet dhe mallrat të cilat ndodhen në një ndërtesë dhe nuk janë të lidhura pazgjidhshmërisht me të.
2.3 Nuk përbëjnë objekt sigurimi sipas kësaj kontrate:
2.3.1 sendet vetiake që u përkasin dhe përdoren nga punonjësit, përveç rasteve kur janë përcaktuar shprehimisht në policën e sigurimit.

Neni 3
Shpenzime te mbuluara

3.1 Siguruesi do të dëmshpërblej shpenzimet përfshirë edhe ato pa efekt, që i Siguruari i ka quajtur të nevojshme të kryej për të mënjanuar ose minimizuar dëmin. Kompensmi i këtyre shpenzimeve së bashku me dëmshpërblimin për njësitë e siguruara nuk do të kalojë shumën e siguruar për njësitë. Në rastin e nënsigurimit shpenzimet do të rimbursohen në të njëjtin përpjestim si dëmtimi, pavarsisht nga udhëzimet e dhëna nga Siguruesi. Nuk do të dëmshpërblehen shpenzimet për shërbimet e kryera nga njësitë zjarrfikse ose personat e tjerë të detyruar për të dhënë ndihmë në interes të popullatës si dhe kur Siguruesi provon se mjetet e përdorura dhe shpenzimet e bëra nga i Siguruari janë përdorur ose janë bërë pa kujdes.
3.2 Siguruesi do të rimbursojë shpenzimet që kryhen në vijim të dëmit si shpenzimet e pastrimit në vendndodhjen e dëmit, përfshirë prishjen e pjesëve të pavlefshme, heqjen e mbeturinave dhe mbetjeve të tjera në vendin më të afërt të hedhurinave

SIGMA INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

dhe shpenzimet e depozitimit ose shkatrrimit të tyre (shpenzimet e prishjes dhe heqjes së mbeturinave); brenda një limiti të përcaktuar në policën e sigurimit, sipas një preventivi, por jo më shumë se 1 % e shumës së siguruar, sidoqoftë nuk do të mbulohen shpenzimet e pastrimit nga ndotja e tokës dhe e ujit.

Neni 4
Rreziqet e sigurimit

4.1 Sigurimi nga zjarri, rrufeja, eksplozioni, rënia e avioneve ose pjesëve të tij.

Siguruesi dëmshpërblen të Siguruarin për humbjen ose dëmtimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e zjarrit, rrufesë, eksplozionit, përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij. Përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjet ose lëvizjet në lidhje me çdo njërën prej ngjarjeve të mësipërme në kufirin deri 3 % të shumës së siguruar.

4.1.1 Përcaktime të rreziqeve të mbuluara:

4.1.1.1 Zjarr do të konsiderohet të jetë një formë e djegijes me flakë e të mirave materiale jashtë vatrës që ekziston qëllimisht për të, e aftë të vetpërhapet dhe të vetzgjerohet.

4.1.1.2 Rrufe do të konsiderohet të jetë një shkrepje e rrufesë, e cila e godet një objekt drejpërdrejt.

4.1.1.3 Eksplozion do të konsiderohet të jetë një çlirim i papritur i energjisë i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve në përpjekje për zgjerim. Shpërthimi i një ene (ngrohëse, tubacione etj.) do të merret në konsideratë si i tillë nëse pareti i enës është dëmtuar në atë shkallë që bënë të mundur barazimin e papritur të presionit brenda dhe jashtë enës. Nëse shkak për shpërthimin brenda enës është një reaksion kimik, atëherë do të dëmshpërblehet çdo dëmtim i enës, dhe nëse paretet e saj nuk janë shkatërruar.

4.1.2 Nuk mbulohen:

4.1.2.1 dëmtimi nga zjarri i objekteve të siguruara shkaktuar nga vënia e tyre në zjarre zjarre përdorimi ose shërbimi. (psh. nese mbi sobe digjen objekte te vena me ose pa dashje) ;

4.1.2.2 djegiet sipërfaqësore, përveç se kur shkaktohen nga njëri prej rreziqeve të mbuluara në Nenin 4;

4.1.2.3 dëmi në motorët me djegie të brendëshme shkaktuar nga shpërthimet e ndodhura brenda dhomës së djegijes;

4.1.2.4 dëmi i shkaktuar ne kontaktet e çelësave elektrike si rrjedhojë e presioneve të gazrave që lindin brenda tyre;

4.1.2.5 dëmi në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik shkaktuar nga rryma elektrike (p.sh. Si pasojë e mbirrymës, tejkalimit të kufijve normal të tensionit mbitensionit ose nëntensionit, defekteve të izolimit si qarqe të shkurtëra, kontakte trupore ose defekte tokëzimi; kontaktit të pamjaftueshëm, mos funksionimit të instalimeve të matjes, kontrollit ose sigurisë);

Nëse një dëmtim i tillë(4.1.2.4-4.1.2.5) shkakton një zjarr apo shpërthim, ai do të mbulohet nga ky sigurim.

4.1.2.6 dëmi në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkte e rrufesë

4.1.2.7 dëmet e shkaktuara nga implozioni;

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP

4.1.2.8 fitimi i munguar dhe dëmet vijuese të çdo lloji dhe natyre të tilla si dëmet për shkak të vonesave, moskryerjes humbjes së kontratës, gjobat etj. Ne rast se nuk eshte siguruar ne menyre te vecante sipas formularit te police

Neni 5
Përjashtime

5.1 Nuk mbulohen:

5.1.1 dëmet e shkaktuara me dashje apo nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit apo e anëtareve madhorë të familjes së të Siguruarit;

5.1.2 Veprimet e pandershme, të qëllimshme ose neglizhenca e të Siguruarit të cilat duhet të parashikoheshin nga I Siguruari duke pasur parasysh natyrën dhe rrethanat e këtyre

5.2 Ky sigurim nuk do të mbuloj dëmtimin e objekteve të siguruara ose shpenzimet e siguruara të lindura ose të shkaktuara drejtpërdrejt ose indirekt si pasojë e;

5.2.1 Shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor dhe ndotjes radioaktive, jonizimit, çdo arme me lëndë bërthamore.

5.2.2 Luftës së çdo lloji invazioni, luftime të tjera të armatosura pavarsisht nëse është deklaruar ose jo lufta civile;

5.2.3 Turbullirave civile, revolucioneve, lëvizjeve seperatiste, kryengritjeve popullore, rebelimeve, revoltave, puçeve, grushteve të shtetit, eksodeve;

5.2.4 Konfiskimeve, rekuizimeve, shtetëzimeve të detyruara të kryera me urdhër të çfardolloj qeverie apo autoriteti shtetëror;

5.2.5 Trazirave, grevave, lokautit, sabotimit, terrorizmit.

Terrorizëm do të konsiderohet kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj pasurisë ndërmjet vjedhjeve, dëmtimeve e shkatërrimeve masive që kanë si qëllim turbullimin e rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë së publikut;

5.2.6 Shpalljes së ligjit të luftës, deklarimit dhe vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, anarkisë ose mosfunksionimit të shtetit, qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit;

5.2.7 Nëse në rastin e një dëmi Siguruesi përdor të drejtën e tij për të mos dëmshpërblyer në bazë të përjashtimeve, I Siguruari do të jetë përgjegjës për të provuar se dëmi që ka ndodhur nuk ishte shkaktuar direkt ose indirekt në lidhje me këto përjashtime;

Neni 6
Shuma e siguruar

Shuma e siguruar, si rregull do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit. Baza mbi të cilin do të përcaktohet shuma e siguruar do të vendoset në policën e sigurimit.

6.1 Për ndërtesat;

6.1.1 Shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të saj.

Vlera e zëvendësimit do të jetë vlera lokale e ndërtimit duke përfshirë shpenzimet e arkitektit dhe shpenzimet e tjera të projektimit.

6.1.2 Në qoftë se ndërtesa nuk është e re pra ka amortizim atëherë shuma e sigurimit do të jetë e barabartë me vlerën aktuale.

Vlera aktuale do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të ndërtesës minus një zbritje në përputhje me gjendjen aktuale të saj, në veçanti me shkallën e amortizimit;

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP

6.1.3 Në qoftë se ndërtesa nuk është në gjendje të mirë dhe nuk do të rindërtohet më atëherë shuma e sigurimit do të jetë e barabartë me vlerën e tregut të saj.

Vlera e tregut do të jetë e barabartë me çmimin e mundshëm të shitjes së ndërtesës ose vlerën e materialit që mund të përfitoj i Siguruari nga prishja e saj.

6.2 Për makineri dhe pajisje;

6.2.1 Shuma e sigurimit, si rregull do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të tyre. Vlera e zëvendësimit, do të jetë vlera për t'u paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të të njëjtit tip dhe cilësi në një gjendje si të reja, cilado qoftë shuma më e ulët;

6.2.2 Në raste të vecanta kur një makineri ose grup makinerish ose pajisjesh nuk mund të përdoren më ose nuk janë të përdorshme për qëllimin e të siguruarit, shuma e siguruar do të jetë vlera e tregut.

6.3 Për mallra që prodhohen, tregtohen, lëndë të para, produkte natyrore.

6.3.1 Shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën maksimale të tyre, e cila përfaqëson vlerën maksimale të mundshme të mallrave të depozituara, deklaruar me shkrim nga i siguruari.

6.3.2 Në raste të vecanta, shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën mesatare të tyre, e cila përfaqëson vlerën që i Siguruari parashikon ta ketë gjatë vitit, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.

6.4 Për pajisjet shuma e sigurimit do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të tyre.

6.5 Në rast të sigurimit në **"bazë të rrezikut të parë"**, i cili do të deklarohet shprehimisht në policën e sigurimit, shuma e sigurimit do të përfaqësoj një pjesë të vlerës së plotë dhe siguruesi do të paguaj në rast dëmi deri në këtë shumë të siguruar, duke mos zbatuar kushtin e nënsigurimit. Primi i sigurimit do të jetë më i lartë nga ai i llogaritur për sigurimin në bazë të vlerës së plotë.

Neni 7
Polica e sigurimit

7.1 Polica e sigurimit që Siguruesi i lëshon të Siguruarit, vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit.

7.2 Në se Polica e Sigurimit humbet ose dëmtohet në masën që behët e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguruarit, Siguruesi duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

7.3 Siguruesi lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit në bazë të të dhënave të Pyetësorit dhe deklarimeve të bëra nga I Siguruari. Pyetësori, njoftimet e deklarimet e tjera të të Siguruarit i bashkëngjiten Policës së Sigurimit dhe janë pjesë përbërëse e saj. I Siguruari është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij.

7.4 Siguruesi ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të të Siguruarit dhe të kryejë inspektime për saktësime të dhënash.

7.5 Kushtet e përcaktuara në Policën e Sigurimit nuk mund të ndryshohen, përveç me shtojcë që është pjesë e Policës nënshkruar nga Siguruesi dhe I Siguruari. Duke pranuar Policën e Sigurimit, I Siguruari pranon se Polica përfshin të gjitha marrëveshjet ekzistuese ndërmjet të Siguruarit dhe Siguruesit ose Agjentëve të tij në lidhje me këtë mbulim në sigurim.

Neni 8
Periudha e sigurimit

8.1 Periudha e sigurimit si rregull është jo më pak se një vit, përveç rasteve kur në Policën e Sigurimit përcaktohet ndryshe, por jo më pak se tre muaj, përjashtuar raste të tilla si ekspozita, panaire etj.

8.2 Mbulimi në sigurim fillon në orën 24°° të ditës së përcaktuar si ditë e fillimit në Policën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit ose kësti i tij i parë. Mbulimi në sigurim përfundon në orën 24°° të ditës së përcaktuar si ditë mbarimi në Policën e Sigurimit.

8.3 Përgjegjësia e Siguruesit do të fillojë në momentin kohor të përcaktuar në policë, edhe nëse pagesa e primit të sigurimit kryhet më parë.

Neni 9
Tarifa e primit të sigurimit

Tarifa do të caktohet në bazë të shumës së sigurimit, masave mbrojtëse dhe kushteve të sigurimit.Tarifa do të caktohet veçanërisht për çdo Policë Sigurimi.

Neni 10
Primi i sigurimit

10.1 I Siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit sipas shumave dhe afateve të përcaktuara në Policë.

10.2 Pagesa e primit të sigurimit bëhet pranë Degës ose agjencisë së Siguruesit ku është lëshuar Polica e Sigurimit. Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë e Siguruesit.

10.3 Primi i sigurimit paguhet në monedhën e përcaktuar në Policën e Sigurimit.

10.4 Primi i sigurimit mund të paguhet tërësisht ose me këste, sipas marëveshjes midis palëve.

10.5 Në rastin e pagesës së primit të sigurimit me këste:

10.5.1 shuma e kështit të parë do të jetë jo më e vogël se 50 për qind e shumës së përgjithshme;

10.5.2 data e pagesës së kështit të dytë do të caktohet jo më vonë se pesë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit;

10.5.3 kësti i fundit do të paguhet jo më vonë se tre muaj nga data e mbarimit të afatit të Policës së Sigurimit.

10.5.4 kur polica e sigurimit është lidhur për një periudhë disa vjeçare, primi i sigurimit do të paguhet me këste vjetore.

10.6 I Siguruari detyrohet t’i paguajë Siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në Policën e Sigurimit.

10.6.1 Në se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, mbulimi në sigurim pezullohet deri në orën 24°° të ditës që i Siguruari paguan shumën që detyrohet.

10.6.2 Kur i Siguruari nuk paguan primet në vazhdim sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24°° e ditës së pesëmbëdhjetë mbas mbarimit të afatit të pagimit dhe Siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Policës së Sigurimit.

10.6.3 Humbjet dhe dëmtimet e vërtetuara brenda afatit të mësipërm dëmshperblehen vetëm pasi të jetë zbritur shuma e kësteve vijuese të primit të sigurimit.

10.6.4 Mospagimi në kohë i kësteve të primit të sigurimit sjell pasojat e mëposhtme:

10.6.4.1 Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit;

10.6.4.2 Siguruesi ka të drejtë të dëmshpërblejë në mënyrë të reduktuar në porporcion me këstin e primit të sigurimit të paguar;

10.7 Kur pasuria e siguruar kalon në pronësine e një personi tjetër, kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Në këtë rast primi i paguar i kthehet të siguruarit në përpjestim me kohën që mbetet deri në mbarim të afatit të kontratës, duke ju mbajtur shpenzimet administrative në masën 20% të primit të pashfrytëzuar.

Neni 11
Pjesa e zbritëshme

Në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesë e zbritshme dhe/ose franshizë.Për çdo rast dëmi Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme dhe/ose franshizën të përcaktuar në Policën e Sigurimit në shumë absolute ose në përqindje. Pjesa e zbritëshme dhe/ose franshiza zbatohet për çdo rast dëmi. Masa e pjesës së zbritshme dhe/ose franshizës do të përcaktohet në Policën e Sigurimit.

Neni 12
Detyrime

12.1 I Siguruari në kohën e lidhjes së kontratës së sigurmit duhet të informojë, me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat janë thelbësore nëse ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të përfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë. Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatin e sigurimit si dhe te zgjidhë kontratën e sigurimit.

12.2 Siguruesi mund gjithashtu të zgjidhë kontratën e sigurimit nëse i është dhënë informacion i gabuar. Primi i sigurimit nuk i kthehet të Siguruarit.

12.3 Në rast dëmi, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhënie dëmshpërblimi kur shkak i dëmit është një rrethanë që nuk i ishte bërë e njohur atij nga I Siguruari.

12.4 Këto dispozita janë të vlefshme edhe për përfituesin, nëse vërtetohet nga Siguruesi se ai kishte dijeni për pasaktësinë e deklarimeve ose harresave në lidhje me rrezikun.

12.5 Nëse i Siguruari ndërmerr ose ndryshon një veprimtari të çfarëdo lloji apo madhësie, ai duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin. Nëse ndërrmarrja apo ndryshimi i veprimtarisë përfshin shtim të rrezikut zbatohen parashikimet e paragrafit 1. Nga dita që është ndërrmarrë ose ndryshuar veprimtaria Siguruesi do të ketë të drejtën për një tarife primi më të lartë. Kjo nuk do të zbatohet nëse

Siguruesi është liruar nga plotësimi i detyrimit të tij në rast dëmi për shkak të shtimit të rrezikut.

12.6 I Siguruari duhet:

12.6.1 Të plotësojë dhe zbatojë të gjitha masat e sigurimit të përcaktuara në mënyrë specifike në policën e sigurimit dhe të tregojë përkujdesjen e duhur në parandalimin e dëmit.

12.6.2 Të ketë të regjistruara letrat me vlerë dokumentat të tjerë, koleksione dhe objekte të tjera për të cilat janë parashikuar që të kryhen regjistrime, dhe t'i ruajë ato në mënyrë të tillë që të mos ketë mundësi të dëmtohen ose humbasin së bashku me objektet e siguruara.

12.7 Nëse I Siguruari nuk arrin të plotësojë kushtet e përcaktuara më sipër, Siguruesi, brenda një muaji që ka marrë dijeni, mund të zgjidhë kontratën e sigurimit duke e njoftuar të Siguruarin me shkrim. Siguruesi do të lirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit nëse shkaku i dëmit ose humbjes është mosplotësimi nga I Siguruari i detyrimeve me qëllim ose nga neglizhenca e rëndë.

12.8 I Siguruari do të lajmërojë menjëherë Siguruesin për:

12.8.1 çdo bashkim ose shkrirje me veprimtari të tjera ekonomike ose çdo blerje, dhënie, transferim, lënie peng apo shitje të pasurive apo aksioneve që shkaktojnë ndryshime në pronësinë ose kontrollin financiar ose tjetër, të veprimtarisë ekonomike;

12.8.2 heqjen e kontrollit të të Siguruarit mbi veprimtarinë ekonomike nga çdo Qeveri apo zyrtar i caktuar nga çdo Qeveri apo Autoritet Lokal.

12.9 Kusht për vazhdimin e mbulimit në sigurim është që I Siguruari t'i japë menjëherë Siguruesit informacionin që Siguruesi do të kërkojë dhe I Siguruari të paguajë primin shtesë siç mund të kërkojë Siguruesi si rrjedhojë e këtij ndryshimi.

Neni 13
Interesi i siguruar

13.1 Nëse interesi i siguruar pushon së ekzistuari pas fillimit të sigurimit si rrjedhojë e një akti lufte ose një veprimi administrativ në rast lufte ose nëse pushimi i interesit është pasojë e paevitueshme e luftës, Siguruesi ka të drejtë ta mbajë pjesën e primit që i përket periudhës së mbulimit të rrezikut.

13.2 Nëse interesi i siguruar pushon së ekzistuari për shkak të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, Siguruesi ka të drejtën e primit për të gjithë periudhën e sigurimit.

Neni 14
Sigurime te tjera

14.1 Nëse I Siguruari kryen sigurim tjetër kundrejt rreziqeve të siguruara për mbulimin e objekteve të siguruara me këtë kontratë, ai duhet t'i njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesit emrin e siguruesit tjetër dhe shumën e siguruar. Nëse I Siguruari, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, nuk plotëson detyrimet e paragrafit të mësipërm, atëherë Siguruesi ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës së sigurimit dhe mospagimit të dëmshpërblimit.

14.2 Nëse ekziston sigurim tjetër masa e dëmshpërblimit që përfiton I Siguruari nga të gjitha kontratat nuk mund të jetë më e lartë se sa masa e humbjes minus pjesën e zbritshme.

14.3 Nëse në kohën e ndodhjes së një ngjarje sigurimi i cili shkakton një humbje sipas kësaj Police ekzistojnë sigurime te tjera prej të Siguruarit ose çdo personi që vepron në emër të tij që mbulojnë një humbjë të tillë ose pjesë te veçanta te saj, përgjegjësia e Siguruesit do të kufizohet në pjesën që i takon në një ngjarje të tillë.

14.4 Nëse I Siguruari kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontratae sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

Neni 15
Mbisigurimi

15.1 Nëse shuma e siguruar e tejkalon ndjeshëm vlerën e sigurimit, atëherë si Siguruesi ashtu edhe I Sigurari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar, si dhe primi i sigurimit do të pakësohet proporcionalisht me zvogëlimin e shumës së sigurimit.

15.2 Nëse I Siguruari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

Neni 16

Nënsigurimi

Nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e sigurimit, dëmshpërblimi i llogaritur do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së sigurar ndaj vlerës së sigurimit.

Neni 17
Anullimi

17.1 Kjo Policë mund të përfundojë në çdo kohë me kerkesë të të Siguruarit dhe në këtë rast Siguruesi do të mbajë primin për kohën që Polica ka qenë në fuqi, si dhe 20% të primit të sigurimit të pashfrytëzuar për shpenzime administrative.

17.2 Kjo Policë gjithashtu mund të përfundojë në çdo kohë me dëshirën e Siguruesit duke njoftuar të Siguruarin lidhur me këtë ndërprerje dhe në këtë rast Siguruesi do të jetë i detyruar të ktheje primin në proporcion me kohën e mbetur nga anullimi i Policës deri në përfundim të saj.

Neni 18
Ngjarja e sigurimit

18.1 Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit i Siguruari duhet:

18.1.1 të njoftojë me shkrim Siguruesin menjëherë duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, si dhe të njoftojë organet e rendit e njësitë zjarrëfikse. Një njoftim i tillë do të quhet

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP

i dhënë Siguruesit menjëherë nëse është dërguar brenda 24 orëve nga ndodhja e ngjarjes;

18.1.2 të marrë të gjitha masat për të shmangur ose minimizuar humbjet ose dëmtimet me sa është e mundur dhe gjatë këtyre veprimeve të ndjekë udhëzimet e Siguruesit; I Siguruari është i detyruar të kërkojë dhënien e këtyre udhëzimeve nëse lejojnë kushtet;

18.1.3 të pajisë Siguruesin me librat e llogarisë dhe libra të tjerë të veprimtarisë së tij ekonomike si fatura, bilance, informacione, evidenca të ndryshme si dhe dëshmi të tjera të pasurisë të tij, të cilat janë të nevojshme të kërkohen prej Siguruesit për qëllim verifikimi ose hetimi të ngjarjes së Sigurimit, bashkë me, një deklaratë ligjore për vërtetësin e deklarimeve dhe të çdo çështjeje lidhur me to, nëse kërkohet;

18.1.4 të lejojë Siguruesin me kërkesën e tij dhe për sa është e arsyeshme, të hetojë lidhur me shkakun dhe shumën e humbjes si dhe masën e dëmshpërblimit, duke i dhënë çdo informacion që ndihmon hetimin.

18.1.5 nëse është e mundur, të mos ndryshojë asgjë në vend ngjarje pa miratimin e Siguruesit;

18.1.6 t'i dorëzojë Siguruesit Brenda 10 ditëve nga ndodhja e ngjarjes një listë të firmosur të të gjitha objekteve të dëmtuara apo të shkatërruara, sipas formularit të dhënë nga Siguruesi, si dhe vlerën për të cilën kërkon të dëmshpërblehet.

18.2 Nëse I Siguruari me qëllim apo për neglizhence nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e mësipërme, Siguruesi çlirohet nga përmbushja e detyrimeve të tij. Nëse organi i rendit nuk është njoftuar për objektet e humbura apo dëmtuara në kohë, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimi i tij vetëm për këto objekte.

Neni 19
Ekspertimi

19.1 Siguruesi brenda 10 ditëve nga njoftimi i të Siguruarit duhet të fillojë ekspertimin e dëmit të ndodhur.

19.2 Në rastet kur i Siguruari nuk pranon plotësisht ose pjesërisht aktekspertimin e Siguruesit, e njofton atë me shkrim brenda tre ditëve nga marrja e këtij akti.

19.3 Lidhur me mosmarrëveshjen të dy palët caktojnë një ekspert tjetër ose një grup ekspertësh të përbërë nga përfaqësues të tyre ose të tretë. Eksperti ose grupi i ekspertëve të lartpërmendur nuk kanë të drejtë të riekspertojnë apo të vazhdojnë riekspertimin e filluar kur vërtetohen dëmtime të tjera të pasurisë së siguruar. Në këto kushte, procedura e ekspertimit do të rifillonte sipas pikës më sipër.

19.4 Ekspertët duhet:

19.4.1 të verifikojnë dhe sqarojnë rrethanat e ngjarjes;

19.4.2 të verifikojnë saktësinë e deklaratave apo përshkrimeve që rezultojnë nga aktet kontraktore dhe të përcaktojnë nëse në momentin e dëmtimit ekzistonin rrethana që kishin ndryshuar rrezikun dhe nuk ishin komunikuar;

19.4.3 të verifikojnë nëse i Siguruari ka plotësuar detyrimet e tij;

19.4.4 të verifikojnë ekzistencën, sasinë dhe cilësinë e sendeve të siguruara;

19.4.5 të kryejnë vlerësimin e dëmit, konform Kushteve te Sigurimit dhe Policës së Sigurimit.

Neni 20
Dëmshpërblimi

20.1 Të gjitha përfitimet sipas kësaj Police do të humbasin nëse një kërkesë për dëmshpërblim e bërë sipas kësaj Police përmban:

20.1.1 Mashtrim, ose

20.1.2 në mbështetje të kërkesës është bërë ose përdorur ndonjë deklarim falls, ose

20.1.3 nga I Siguruari apo dikush tjetër që vepron në emër të tij janë përdorur mënyra ose mjete mashtruese për të përfituar sipas kësaj Police, ose

20.1.4 nëse çdo dëm shkaktohet nga veprimet e qëllimshme ose me paramendim të të Siguruarit.

20.2 Nëse padia për dëmshpërblim nuk është paraqitur në Gjykat brenda dy vjetësh nga data që Siguruesi e ka refuzuar ngjarjen e sigurimit, Siguruesi çlirohet nga detyrimet e tij.

20.3 Detyrimi i Siguruesit për dëmshpërblim kufizohet deri në masën e shumës së siguruar. Dëmshpërblimi nuk do të jetë më i lartë se masa e humbjes, edhe nëse në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar është më e lartë se vlera e sigurimit.

20.4 Do të dëmshpërblehet si më poshtë:

20.4.1 Ndërtesa:

20.4.1.1 në rastin e objekteve të shkatërruara ose humbura si pasojë e një ngjarje sigurimi. Siguruesi do të dëmshpërblejë vlerën e siguruar sipas nenit 6.1;

20.4.1.2 në rastin e objekteve të dëmtuara si pasojë e një ngjarje sigurimi, Siguruesi do të dëmshpërblej shpenzimet e riparimit që bëhen të nevojshme nga dëmtimi, por jo më shumë se vlera e siguruar sipas nenit 6.1. Kur sigurimi është bërë në bazë të vlerës aktuale do të bëhet një zbritje në përputhje me shkallën e amortizimit;

20.4.2 Makineria dhe pajisjet

20.4.2.1 në rastin e objekteve të shkatërruara ose të humbura, Siguruesi do të dëmshpërblej vlerën aktuale menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimi sipas nenit 6.2 dhe përcaktuar në Policën e Sigurimit. Shpenzimet për transportin, koston e montimit, taksat doganore do të dëmshpërblehen në qoftëse se në momentin e marrjes në sigurim këto shpenzime janë përfshirë veçanërisht në shumën e siguruar;

20.4.2.2 në rastin e objekteve të dëmtuara Siguruesi do të dëmshpërblejë shpenzimet e nevojshme që duhet të bëhen për restaurimin e makinës së dëmtuara në gjendjen e mëparshme sipas nenit 6.2, dhe e përcaktuar në Policën e Sigurimit, por jo më shumë se vlera aktuale, menjëherë para ndodhjes së ngjarje së sigurimit.

20.4.3 mallrat; në rastin e mallrave të shkatërruara, të humbura ose të dëmtuara, Siguruesi do të dëmshpërblejë vlerën e tyre përkatëse, por jo më shumë se shuma e siguruar sipas nenit 6.3 e përcaktuar në Policën e Sigurimit.

20.4.4 nga dëmshpëblimi do të zbritet vlera e pjesëve të mbetura ose të shpëtuara;

20.4.5 nuk do të merren parsysh shpenzimet për punimet restauruese të vendosura nga autoritetet shtetërore dhe shpenzimet shtesë që janë rrjedhojë e progresit teknologjik.

20.5 Dëmshpërblimi maksimal që do të paguajë Siguruesi për çdo dëm nuk do të kalojë shumën e siguruar të rënë dakord për secilin object.

20.6 Siguruesi mund të shtyjë kohën e pagesës:

20.6.1 për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit për të marrë pagesën;

20.6.2 në qoftë se janë filluar hetime penale në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit;

20.6.3 për aq kohë sa i Siguruari nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi.

20.7 Pas likuidimit të dëmshpërblimit, objektet mbeten të siguruara deri në mbarim të afatit të kontratës së sigurimit për diferencë midis shumës së siguruar dhe dëmshpërblimit të paguar, duke bërë për këtë shënime të veçanta në policën e sigurimit. Me kërkesën e të Siguruarit, shuma e siguruar mund të rivendoset duke paguar prim shtesë dhe duke bërë shënimet përkatëse në policën e sigurimit.

20.8 Siguruesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së dokumenteve të dëmit nga I Siguruari, detyrohet që:

20.8.1 të bëjë pagesën në rast të dëmshpërblimit.

20.8.2 të shpjegojë arsyet e refuzimit, në rast të refuzimit.

Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin për dëmin duke paguar me para, duke riparuar ose zëvendësuar sipas zgjedhjes së Siguresit.

Neni 21
Kalimi i të drejtës (sabrogimi)

I Siguruari sipas këtyre kushteve, me shpenzimet e Siguruesit, do të kryejë dhe do të lejojë të kryhen të gjithë ato veprime që mund të jenë të nevojshme ose të kërkuara nga Siguruesi në interes të çdo të drejte ose mjeti ose dëmshpërblimi të pjesshëm ose të plotë prej palëve nëse këto veprime ose çështje janë ose bëhen të nevojshme ose kërkohen para ose pas dëmshpërblimit prej të Siguruarit.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarveshjeve

Mosmarrëveshjet në qoftë se nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata e vendit ku është lidhur Polica e Sigurimit.

Neni 23
Aplikimi i ligjit

Për gjithçka që nuk është parashikuar në këto kushte do të aplikohen normativat ligjore.

Neni 24
Dispozita te fundit

24.1 Klauzola e përjashtimit të sulmeve kibernetike

Pavarësisht dispozitave të përmbajtjes së ndryshme brenda këtij sigurimi ose çdo miratimi pranohet që ky sigurim përjashton humbjen, dëmtimin real dhe personal të pasurisë, kostot ose shpenzimet e çfarëdo natyre, të shkaktuara direkt ose indirekt të shkaktuara nga çdo sulm kibernetik, qe rrjedhin nga perdorimi si mjet per te shkaktuar dem i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashes, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi apo paisje tjeter elektronike.

24.2 Klauzola e perjashtimit te semundjeve ngjitese

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të ofroje mbulim dhe Siguruesi nuk do te jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim per cdo dem qe lidhet me deme trupore (perfshire Stresin Emocional ose traumen mendore ose fobine), cdo llloj demesh ose humbjesh materiale, te cilat jane ose pretendohet te jene shkaktuar nga, te ndikuara nga ose ne cdo menyre te lidhura me:
Sindromen e fituar te imunitetit te ulur (SIDA/AIDS) ose agjeneteve patologjik te tij ose hepatiti;
Semundjet ngjitese: Me semundje ngjitese do te kuptohet cdo semundeje, e cila mund te transmetohet midis njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose me anë të ndonjë substanca ose agjenti nga ndonjë organizëm në një organizëm tjetër, kur:
- substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshim të tij, qoftë ai që konsiderohet i gjallë ose jo, dhe
- metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin por nuk është e kufizuar në, transmetimin në ajër, transmetimin e lëngjeve trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngshëm ose gaz ose midis organizmave, dhe
- sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mirëqenies njerëzore ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëm, përkeqësim, humbje të vlerës së, tregtueshmërinë ose humbjen e përdorimit të pasurisë

24.3 Klauzola e Sanksioneve

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për demshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkese të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit Europian, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

001 Termeti

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga termeti, si dhe zjarri i cili pason termetin.

Me kusht qe:

- termeti duhet te jete i rregjistruar nga stacionet sizmike, si dhe te kete nje vlere jo me te vogel se 4 Balle sipas shkalles Rihter.
- ndertimi te jete bere ne perputhje me kushte sizmike te zones.
- shuma e siguruar e termetit te jete 100% e shumes se siguruar te zjarrit.

Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimet:

- ne themelet e nderteses
- ne afresket dhe zbukurimet murale
- ne enet uje mbajtese te vendosura ne muret, gardhet ose rrethimet e jashtme
- lindur, shkaktuar, shtuar direkt ose indirekt nga reaksioni berthamor, rrezatimi berthamor ose ndotjet radioaktive

shkaktuar nga permbytja, vershimi, valet e batices.

002 Stuhia

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te, dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te stuhise.

Stuhi do te konsiderohet nje levizje ajri me force jo me te vogel se 8 shkalle (17.2 m/s ose 62 km/ore) shkaktuar nga kushtet metereologjike.Ne qofte se nuk ka matje nga stacionet meterologjike qe kjo force ere mbizoteron kur ndodh nje ngjarje, do te jete e mjaftueshme ne qofte se I Siguruari sjell te dhena qe ne afersi te zones se siguruar, stuhia shkakton humbje ose deme ne ndertesat e ndertuara siç duhet ose ne objektet e tjera me rezistence te njejte ose qe duke marre parasysh konstruksionin e rregullt te nderteses, humbja ose demi te jene shkaktuar vetem nga stuhia.

Siguruesi do te paguaje demshperblimin per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga stuhia, nese shkaterrimi ose demtimi:

- shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhise ose
- shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjese te nderteses, peme ose objekte te tjera brenda objekteve te siguruara ose nderteses ne te cilen jane vendosur objektet e siguruara ose
- eshte si pasoje e humbjes ose demit te shkaktuar nga stuhia ne objektet e siguruara ose elemente te nderteses te ketyre objekteve.

Ky mbulim nuk do te shtrihet tek:

- humbja ose demi ne ndertesat qe nuk jane gati per shfrytezim ose objekte brenda ndertesave te tilla;
- humbja ose demi I shkaktuar nga permbytja ose orteku;
- humbja ose demi per shkak te shiut, bresherit, debores ose hyrjes te papastertive nepermjet dritareve te cilat nuk kane qene mbyllur ose nepermjet hapjeve te tjera, ne qofte se te tilla hapje nuk jane shkaktuar nga vete stuhia
- humbja ose demi ne objektet e vendosura jashte;

humbja ose demi ne objektet e fiksura jashte ndertesave (p sh sinjale, ndriçuesa neon, tenda, qepena, antena radio ose televizive) linja elektrike mbitokesore, duke perfshire mbeshteteset, shtyllat ose gardhet.

003 Bresheri

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te bresherit.

Mbulimi ne sigurim nuk do te shtrihet tek:

- ndertesat qe nuk jane gati per shfrytezim ose objekte brenda ketyre objekteve
- humbja ose demi per shkak te shiut, bresherit, debores, papastertive qe hyjne nepermjet hapjeve te tjera, nese hapje te tilla nuk jane shkaktuar nga vete bresheri
- humbja ose demi ne objektet e vendosura jashte;
- humbja ose demi ne objekte e fiksuara ne pjesen e jashtme te ndertese (p sh sinjalet, ndriçuesit neon, tenda, qepena, antena radio ose televizive) linja elektrike mbitokesore, duke perfshire mbeshteteset, shtyllat ose gardhet

I Siguruari garanton mirembajtjen e rregullt te objekteve te siguruara, veçanerisht çative.

004 Permbytja

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te permbytjes.

Permbytje do te konsiderohet rasti kur:

- uji i shtratit te qendrueshem (lumit, liqenit, detit) permbyt rastesisht vendin ku eshte vendosur pasuria e siguruar, vershon duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, çan ledhet dhe digat dhe shperndahet per shkak te rrymes se ujit me nivel te larte, valeve dhe ujit te tepert nga liqenet artificiale;
- vershimi i ujit per shkak te shiut te madh, te papritur, si dhe vershimi rastesisht per shkak te rreshjeve shume te medha, gerryen gjate pjerresive, rrugeve;
- tejkalohet ngritja e nivelit te ujrave siperfaqesore dhe nentokesore, krahas me pasojat e saj, por vetem kur kjo prek trupin e objektit ne uje. Ngritja e nivelit te ujrave siperfaqesore matet sipas gjendjes mujore normale te ujit ose prurjes te tij te matur ne hidromatesin me te afert. Per çdo muaj ne veçanti konsiderohet normal niveli me I larte I ujit ose prurja e tij gjate 20 viteve te fundit, perveç rasteve kur nivelet ekstremale te ujit jane tejkaluar jashte mase;
- ky sigurim mbulon vetem demet e shkaktuara ne artikujt e siguruar gjate vershimit (permbytjes) ose menjehere pasi uji ka vershuar;
- ky sigurim nuk mbulon demet per shkak te:
  - influences mekanike te ujit brenda tubacioneve te ujit, kanaleve, tuneleve;
  - kalbezimit te thate;
  - fundosjes, uljes se tokes, qe rrjedh nga permbytja;
  - ndikimit te ujit te nendheshem ne pilota, gropa themeli ose punime te ndryshme, puse miniere, koridore nentokesore dhe gropa minerare.
  - ujit te leshuar prej sistemeve te vaditjes, me kusht qe vershimi I tij jashte nuk eshte pasoje e permbytjes;
  - vendosjes te objekteve te siguruara ne shtrate lumi ose perroi te thate dhe aktive, ose ne hapsiren midis shtratit te lumit dhe bregut te lumit (hapesira e vershimit);
  - magazinimit te mallrave jo sipas rregullave te kerkuara;
  - mallrave dhe produkteve te gateshme te cilat nuk jane vendosur dhe sistemuar ne rafte qe te jene te ngritura nga toka te pakten 20 cm.

Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimet ne ndertesat e ngritura mbi uje, te shkaktuar nga errozioni nga jashte; ne kanalet, tunelet ose tubacionet e ujit si dhe demet e shkaktuara nga presioni per shkak te permbytjes, n.q.s. nuk eshte rene dakord ndryshe.

005 Rreshqitja e Tokes

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te rreshqitjes se tokes.

- Ky sigurim mbulon humbjen ose demin per shkak te rreshqitjes se siperfaqes se tokes ne zona te pjerreta, me plasaritje dhe çarje ne forme damaresh, qe shihen qarte, te cilat ne periudha te shkurtera kohe shkaktojne deformacione statike te rrezikshme ose çarje te medha ne ndertesat.

- Siguruesi çlirohet nga detyrimi per te paguar kerkesat per demshperblim ne rastet kur :
  - zona ku eshte vendosur ndertesa ka filluar te rreshqase perpara se te leshohet Polica e Sigurimit;
  - veprimet e njeriut (si hapje kanali, germime, sizmiciteti i induktuar, etj.) çojne ne nje shkeputje tektonike siperfaqsore;
  - ndodh ulje, fundosje e themeleve, cedim;
  - ndodh nje rreshqitje e vogel gjeologjike e tokes dhe qe duket ne çarje te vogla te ndertesave;
  - ka gropethithese, goditje ose shkaterrime te malit ndersa punohet nentoke apo mbi siperfaqen e tokes (karriera) neper galeri ose ballin e saj;
  - ka rreshqitje te poshtme te strukturave te reja ose vendbanimeve ose errozion bregdetar;
  - ka demtim ne ose qe duket ne levizjen e pllakave te dyshemese, nese themelet e poshtme te mureve te jashme te nderteses nuk jane te demtuara ne te njejten kohe;
  - ka demtime ne muret e pishinave, verandave, tarracave, rrugeve, portave, gardheve ose kopshteve, nese ndertesat ose ngrehinat ndihmese ose garazhdet nuk jane te demtuara ne te njejten kohe;
  - perdoren materiale difektoze ose demet qe rrjedhin nga te metat e mjeshterise gjate periudhes se ndertimit te themeleve;
  - rreshqitja ka ardhur si rezultat i permbytjes.

Ky sigurim nuk do te mbuloje shpenzimet per permiresimin e tokes.

006 Rrjedhja e Tubacioneve

Dëmtimet e tubacioneve të ujit do të merren parasysh nëse janë efekti i drejtpërdrejtë i ujit të tubacioneve që rrjedh nga tubat që bartin ujë, ingranazhet ose paisjet e lidhura me to.
Sigurimi për ndërtesat përfshin gjithashtu dëmet e mëposhtme:

- dëmtimi nga ngrirja e në tubacionet e ujit, ingranazhet ose paisjet e lidhura;
- prishja e tubacioneve të ujit ose e filetimit të tyre;
- jashtë ndërtesës së siguruar, prishja e tubave të furnizimit dhe shkarkimit nga ngrica dhe dëmtimet, për sa kohë përdoren për të furnizuar ndërtesën e siguruar dhe ndodhen në zonën e siguruar janë gjithashtu të sigurara, deri në një distancë prej 10 metrash.

Sigurimi mbulon gjithashtu shpenzimet e mëposhtme:

- shpenzimet e shkrirjes;
- shpenzimet e kërkimit, siç janë: shpenzimet që dalin për të gjetur vendin e dëmit, duke përfshirë edhe dëmtimin e shkaktuar;
- shpenzimet për eliminimin e bllokimit në tubacionet e furnizimit dhe shkarkimit brenda dhe jashtë ndërtesës në zonën e siguruar.

Nuk sigurohen dhe nuk jane te mbulueshme, edhe nëse janë si pasojë e paevitueshme e një dëmi, sa me poshte:

- Dëmet që kanë lindur përpara fillimit të sigurimit, edhe nëse ato shfaqen pas fillimit të sigurimit;
- dëmtime në ingranazhe ose në paisjet e lidhura me to;
- dëmet e shkaktuara nga rritja e lagështirës;
- dëmtimet në sistemet që janë ekskluzivisht për kullimin të reshjeve atmosferike;
- dëmtimet e shkaktuara nga sistemet e sprinklerave;
- dëmtimet e shkaktuara nga rrjedhja e ujit nga pishinat;
- dëmtimet në mallrat e ruajtura ne katet nën nivelin e tokës, të cilat nuk janë të ruajtura të paktën 12 cm mbi dysheme;
- humbja e ujit, humbja e qerasë, ose dëmtime të tjera indirekte;
- dëmtime të shkaktuara nga ngritja e tabelës së ujit, ujit nga reshjet atmosferike ose presioni i shkaktuar nga këto;

dëmtimet nga dekompozimi, prishja dhe myku;

009 Aktet keqdashese

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara te cilat jane shkaterruar ose demtuar direkt ose indirekt nga veprimet (aktet) keqdashese:

Me veprime (akte) keqdashese do te kuptohet humbja, shkaterrimi ose demtimi, shkaktuar nga zjarri, eksplozioni ose te tjera) e Pasurise se siguruar shkaktuar direkt ose indirekt nga demtimet keqdashese te çdo personi ose grup personash.

Perjashtohen nga ky mbulim:

a) humbja ose demtimi qe rezulton nga ndalesa totale ose e pjesshme ose nderprerja e punes, ose vonesa e punes ose i çdo lloj procesi ose operacioni tregtar ose industrial;

b) humbjet (te perkohshme ose te perhershme) te pasurise se siguruar ose te çdo pjese te saj per arsye konfiskimi, rekuizimi, ndalimi ose dhunimi te kesaj pasurie, ose dhunimi I çdo pasurie perreth qe I perket te Siguruarit, çdo mjeti transporti ose sendi te ngjashem me te ;

humbja e te ardhurave, humbja nga vonesat, humbja e tregut ose humbja/demtimi vijues apo indirekt I çdo lloji ose pershkrimi tjeter.

011 Humbja e Fitimit nga Nderprerja e Biznesit
si Pasoje e Rreziqeve te Siguruara

Eshte rene dakord dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakord per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar te ardhurat e munguara dhe dëmet vijuese të saj të shkaktuara nga njëri prej rreziqeve të siguruara ne Policen e Sigurimit. Siguruesi do të dëmshpërblejë dëmin që lind nga ndërpreja ose nga ky ndikim.

Në rast se biznesi i të siguruarit është ndërprerë ose ka ndikim nga dëmi në pronë i cili është shkaktuar nga njëri prej rreziqeve të siguruara, siguruesi do të dëmshpërblejë dëmin që lind nga ndërpreja ose nga ky ndikim.

Në rast se biznesi që kryen i Siguruari në njësinë e siguruar ndërpritet si pasojë e rreziqeve siç përcaktohen në Policen e sigurimit te Zjarrit dhe Rreziqet Shtese, kushtet e pergjithshme te mbulimit të kësaj police (humbja, shkatërrimi apo dëmtimi i shkaktuar këtu e më poshtë do të quhet Dëmi) në ndonjë ndërtesë apo pasuri ose pjesë të tyre të përdorura nga i Siguruari në ushtrimin e biznesit siç përshkruhet në Formular atehere Siguruesi do t'i paguajë Policëmbajtësit/të Siguruarit përfitimin e pagueshëm për humbjen që rrjedh nga kjo ndërprerje në përputhje me parashikimet që përmbahen këtu me kusht që në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit të ketë qenë në fuqi një sigurim që mbulon interesin e të Siguruarit në pasurinë në njësinë e siguruar dhe pagesa do të jetë kryer (ose do të kishte qenë kryer por nuk është kryer për shkak të aplikimit të pjesës së zbritshme) ose përgjegjësia do të ishte pranuar sipas këtij sigurimi.

BAZA E LLOGARITJES SË DËMSHPËRLIMIT

Sigurimi kufizohet në humbjen e te ardhurave ditore për cdo dite vonese ne riparimin e nje demi i cili eshte shkaktuar nga rreziqet e permendura me siper por jo me shume se limiti maksimal i demshperblimit sipas percatimeve ne formularin e kesaj police sigurimi.

Demshperblimi fillon menjehere pas aplikimit te pjeses se zbritshme, me ndodhjen e ngjarjes se siguruar dhe i Siguruari duhet te filloje pergatitjen per paraqitjen e te gjithe dokumentacionit te demit nga ana e te Siguruarit.

Limiti i Demshperblimit eshte vlera mesatare e te ardhurave mujore sipas deklarimit nga i Siguruari dhe percaktimit ne shtojcen bashkangjitur. Pavaresisht nga kjo, limiti i demshperblimit per cdo ngjarje nuk mund ta kaloje asnjehere te ardhurat mesatare mujore per cdo vendndodhje.

012 SIGURIMI I XHAMAVE

Eshte rene dakort dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet deri ne masen dhe ne menyren qe parashikohet ketu e me poshte, te demshperbleje te Siguruarin deri ne shumen e vendosur ne Formular ne lidhje me :

1. Thyerjen e te gjithe fleteve dhe/ose shtresave te xhamit te fiksuara ne dritaret dhe dyert e ndertesave duke perfshire pjeset e ambjentit rrethues qe jane te perfshira ne aktivitetin e Biznesit te te Siguruarit te paraqitura ne Formular dhe te xhamave te jashtem te ndertesave, duke perfshire pasqyrat e fiksuara ne mure dhe xhamat e fiksuara ne vitrine (perveç dhomave frigoriferike per ushqime te ngrira).
2. Shpenzimet e zevendesimit te skeletit te dritareve dhe pajisjeve te tyre qe demtohen si rrjedhim i thyerjes se ketyre xhamave nga çdo shkak
3. Gjithashtu Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin në lidhje me dëmin në mallrat e vendosura në dritare që vjen si shkak i thyerjes së këtyre xhamave deri në vlerën 30,000 leke për të gjitha rastet në total gjatë Periudhës së Sigurimit

Perjashtimet.

Nuk do te demshperblehen :

1. Shkrimet e shkrojtura mbi xhama, relievimet mbi xhama, perkuljet e xhamave;
2. Shpenzimet e rilevizjes dhe rimagazinimit te skeleteve te dritareve si dhe te paisjeve te tyre (nese nuk perfshihen ne Formular);
3. Humbjet e shkaktuara nga vonesat ose nderprerja e Biznesit;
4. Thyerja ose dëmtimi që vijnë si rezultat i riparimeve, zbukurimeve, shtesave ose ndryshimeve në zonën përreth që është në pronësi të të Siguruarit ose thyerja ose dëmtimi i xhamave të vendosur në mënyrë korrekte dhe që vijnë si pasojë e këtyre thyerjeve ose dëmtimeve;
5. Xhamat qe konstatohet se jane demtuar para fillimit te periudhes se sigurimit si dhe çdo dem vijues i ketij demi;
6. Pjesa e zbritshme e shenuar ne Formular e cila duhet zbritur ne çdo rast thyerje ose demi;
7. Thyerja ose dëmtimi i shkaktuar nga zjarri.

Kushtet

1. Klauzola e Vleresimit.

Aty ku xhamat e ndonje lloji qe jane te siguruar sipas ketij Seksioni nuk prodhohen me, atehere vlera e xhamit te thyer do te merret sipas çmimit te fundit qe disponohet nga nje prodhues xhamash qe eshte me reputacion dhe qe prodhon xhama te ngjashem me xhamin e thyer si dhe palet do te vendosin bashkarisht.

2. Klauzola e pjeseve te shpetuara.

Ne lidhje me pagesen e demshperblimit Siguruesi ka te drejte te zbrese nga shuma e demshperblimit vleren e çdo pjese te shpetuar te perdorshme, dhe i Siguruari me shpenzimet e tij, do te marre te gjitha masat per te ruajtur pjeset e shpetuara dhe do te levize çdo germe (a), ornament (e) dhe sende te ngjashme me to qe nuk jane te ngjitura me xhamin e demtuar.

3. Klauzola e Periudhes se Sigurimit dhe Shumes se Siguruar.

Periudha e Sigurimit eshte e njejte me ate te Polices se Sigurimit nga Zjarri. Shuma e siguruar eshte e paraqitur ne formularin baze.